



REPUBLIKA E KOSOVËS



KOMUNA E ISTOGUT

KONTRATË PËR PUNË

KOMUNA E ISTOGUT në vazhdim "Njësia e Prokurimit", të cilën e përfaqëson znj, **Zizë Bujupaj**, menaxhere e Prokurimit, Rruga "Fadil Ferati" Nr. 121 në njërën anë;

Dhe

KONTRAKTORI "SIB" Shpk, Komuna e Istogut, të cilën e përfaqëson z. **Sabit Mslija**, me Nr. Rexh. Unik i Biznesit, 811223669 (ne vazhdim Kontraktuesi), ne anën tjetër, janë pajtuar te lidhin një kontratë publike për punë e shënuara me poshtë:

TITULLI I KONTRATËS:

PASTRIMI DHE RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT KUJAVQ

Nr. I prokurimit	633-20-5260-5-2-1/ C 387
Nr. I brendshëm	633 / 020/ 080 / 521

Neni 1 Lënda:

1.1 Lënda e kontratës është ekzekutimi i furnizimeve dhe punëve në vijim nga ana e Kontraktuesit:

PASTRIMI DHE RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT KUJAVQ

Neni 2 Çmimi

2.1 Çmimi total i punëve per aktivitetin e prokurimit **PASTRIMI DHE RREGULLIMI I SHTRATIT TË LUMIT KUJAVQ** është: 25.436,67 € dhe me fjalë: /Njëzetepesëmijëkatërçindetridhjetëegjashtë-67/100 €

2.2 Çmimi i përmendur në Nenin 2.1 më sipër duhet të jetë e vetmja pagesë që Autoriteti Kontraktues i ka borxh Kontraktuesit sipas kontratës. Ai duhet të jetë i prerë dhe të mos i nënshtrohet ndryshimeve përgjatë ekzekutimit të kontratës.

2.3 Pagesat do të bëhen në pajtim me Kushtet e përgjithshme dhe/ose të Veçanta të kontratës.

Neni 3 Rendi i përparësisë i dokumenteve të kontratës

3.1 Kontrata përbëhet nga dokumentet në vijim:

Marrëveshja e kontratës;
Kushtet e Veçanta të Kontratës;
Kushtet e Përgjithshme të Kontratës;
Tenderi i Kontraktuesit, duke përfshirë edhe Specifikimet Teknike;
Oferta financiare (Paramasa dhe Parallogaria);
Plani për menaxhimin e kontratës
Proçesverbalet e Vizitës në teren e mbikqyresi

3.2 Dokumentet e ndryshme që e përbëjnë kontratën konsiderohet se shpjegojnë njëra tjetrën; dhe në raste të paqartësisë ose divergjencës, ato duhet të lexohen sipas rendit të përparësisë në të cilin janë dhënë më sipër.

Neni 4. Afati i përmbushjës së kontratës:

4.1 Kontrata do të përmbushet në afat prej 60 ditësh, nga data e nënshkrimit të se njëjtës, perkatesisht me se larti deri me: 20.12.2020

4.2 Në qoftë se Kontrata nuk përmbushet në afatin e paraparë, e njëjta do të ndërpritet dhe kompanija do të përgjigjet për demet eventuale të shkaktuara Autoritetit Kontraktues, sipas kushteve të përgjithshme dhe të veçanta të kontratës.

Neni 5 Komunikimet

5.1 Të gjitha komunikimet me shkrim që kanë të bëjnë me këtë Kontratë ndërmjet Autoritetit Kontraktues, nga njëra anë dhe Kontraktuesit nga ana tjetër duhet të cekin titullin e Kontratës dhe numrin e saj të identifikimit dhe duhet të dërgohen me postë, faks, email ose të dorëzohen personalisht. Komunikimet për Autoritetin Kontraktues mund të adresohen Autoritetit

Kontraktues ose Menaxherit të Projektit i emëruar në Kushtet e Veçanta të Kontratës.

5.2 Nëse personi që dërgon komunikatën kërkon vërtetim të pranimi të saj, ai duhet ta thotë këtë në komunikatën e tij. Sa herë që ka afat të fundit për pranimin e komunikatës me shkrim, dërguesi duhet të kërkojë vërtetim të pranimi të komunikatës së tij. Në të gjitha rastet, dërguesi duhet t'i marrë të gjitha masat e nevojshme për të siguruar pranimin e komunikimit të tij.

5.3 Kudo në kontratë parashikohet për dhënien e ndonjë njoftimi, pëlqimi, miratimi, certifikate, ose vendimi, përveç nëse specifikohet ndryshe në njoftim të tillë, pëlqim, miratim, certifikatë apo vendim do të jetë në formë të shkruar dhe fjalët "njofton", "vërtetohet", "miratoj" ose "vendosë" do të interpretohen në përputhje me rrethanat. Ndonjë miratim, pajtim, certifikatë ose vendim i tillë nuk duhet të mbahet apo vonohet pa arsye.

5.4 Kjo kontratë është e përgatitur në gjuhën shqipe në tri origjinale, dy prej të cilave janë për Autoritetin Kontraktues dhe një origjinale për Kontraktuesin.

Për Autoritetin Kontraktues:
Komuna e Istogut

Për: Kontraktuesin:
"SIB" Shpk

Emri:	Zizë Bujupaj	Emri:	Sabit Muslija
Pozita:	Zyrtar Përgjrgjës i Prokurimit	Pozita:	D r e j t o r
Nënshkrimi:		Nënshkrimi:	
Data:	20.10.2020	Data:	20.10.2020
Vu la		Vu la	

PJESA III E KONTRATES kushtet e veçanta

KVK në vijim do të plotësojnë dhe/ose ndryshojnë KPK. Sa herë që ka një konflikt, dispozitat këtu do të mbizotërojnë mbi ato të KPK.

[Udhëzimet për plotësimin e KVK janë dhënë, sipas nevojës, në shënimet kursive të përmendura për nenet përkatëse të KPK. Fshini ato jo relevante]

Kushtet e Përgjithshme të Kontratës		Amandamentimet/Modifikimi i Nenit përkatës në KPK
Përshkrimi i nenit	Neni. Nr.	
Ligji i zbatueshëm dhe gjuha	2.1	Ligjet e Kosovës që janë në fuqi do të zbatohen për të gjitha çështjet që nuk mbulohen nga dispozitat e kontratës. Juridiksioni do të jetë gjykata përkatëse në Prishtinë.
	2.2	Gjuha e përdorur do të jetë GJUHA SHQIPE
Siguria e ekzekutimit	10.1	Shume e sigurisë së ekzekutimit është 10% E VLERES SE KONTRATES ME VLEFSHMERI 90 DITE.
Përgjegjësia dhe Sigurimi i Kontraktuesit	11.2	Shuma minimale e sigurimit do të jetë: Sigurimi i vend punishtes do te jete përgjegjësi e Operatorit Ekonomik dhe te gjitha dëmtimet e punëve, dëmtimet e pronës apo humbjet e materialeve dhe pajisjeve ne vend punishte janë ne përgjegjësi te Operatorit ekonomik deri ne shumen e dëmtimeve apo humbjeve, sigurimi i vend punishtes do te jetë + 30 dite nga plani dinamik i ofruar pra nëse zgjasin punimet zgjatet edhe sigurimi i vend punishtes pra + 30 dite.
Fillimi i punëve	17.1	Data e fillimit do të jetë 5 dite nga nënshkrimi i kontrates
	17.2	Data e përfundimit e të gjitha Punëve do të jetë: 60 ditë.
Dëmet e likuiduara	19.1	Dëmet e likuiduara për të gjitha Punët janë 0.25% për ditë por jo më shume se 10% e vlerës së kontratës.
Regjistri i punës	20.1	Ditari i Punës dhe Libri ndërtimor
Inspektimi dhe testimi	22.1	Menaxheri i Projektit është DREJTORI I NJESISE KERKUESE
Parapagimi	26.1	Shuma e Parapagimit është:SKA
Zgjidhja miqësore e mosmarrëveshjeve	42.2	Palët do te provojnë ne mënyrë miqësore ti zgjidhin marrëveshjet ku do te organizojnë se paku tre takime për zgjidhje miqësore e nëse këto takime nuk kane efekt atëherë kompetente do te jetë gjykata.
Zgjidhja e mosmarrëveshjeve me procedurë gjyqësore	43.1	<i>[Çdo mosmarrëveshje ndërmjet palëve të cilat mund të lindin gjatë ekzekutimit së kësaj kontrate dhe se nuk është e mundur të zgjidhet ndryshe ndërmjet palëve do të dorëzohet Gjykata Themelore në Prishtinë në pajtim me ligjin në Kosovë</i>

**PASTRIMI DHE REHABILITIMI I LUMIT "KUJAVCA"
PERMBLEDHJE**

1.PUNËT E PREGADITORE - DEMOLUESE					
Poz.1	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
1.1	Mobilizimi i ndermarrjes per fillimin e punimeve ne project.Te kalkulohet edhe kosto e perpilimit te planit dhe programit punues si dhe e gjithe kosto e transportit dhe vendosjes se makinave ne terren.	Komplet	1.00	55.00	55.00
1.2	Pozicionimi gjeodezik dhe shënjëzimi i trases pergjate gjithe lumit.	m'	4,850.00	0.05	242.50
1.3	Percjellja gjeodezike e punimeve ne baze ditore per gjithe trasen gjate gjithe kohes se kryerjes se punimeve.	m'	4,850.00	0.05	242.50
1.4	Furnizimi dhe punimi i WC-se fushore per gjate gjithe kohes se kryerjes se punimeve.Te parashifet edhe demontimi i WC-se pas perfundimit te punimeve.	Komplet	1.00	25.00	25.00
1.5	Pastimi i brezit te lumit nga te dy anet e shtratit te lumit duke perfshir prerjen,heqjen dhe largimin e te gjitha pengesave(drunje,gure,mbeturina,cunga etj)dhe hudhja e tyre ne deponine e caktuar nga organi mbikqyres.	m'	9,700.00	0.20	1,940.00
1.6	Bartja dhe heqja e materialit te panevojshem dhe te tepert nga punishtja dhe hudhja e tij deri ne deponine me te afert te caktuar nga organi mbikqyres.Materiali i tille most e hudhet anash shtratit por te bartet dhe hiqet nga terreni.	m ³	3,250.00	0.30	975.00
1.7	Perdorimi i pompave per largimin e ujrave gjate kryerjes se punimeve ndertimore(sipas nevojje)	ore	45.00	1.00	45.00
1.8	Pastrimi i mire i te gjitha llojeve te dheut dhe zgjerimi i mire i shtratit te lumit ne hyrjedhe dalje te urave qe te mundesohet kalimi sa me i lehte i ujit nen ure.	cope	3.00	380.00	1,140.00
					4,665.00

2.PUNËT E DHEUT-GERMIMIT DHE MBUSHJES					
Poz.2	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
2.1	Punimet e germimit te kategorise III,IV dhe V(perfshijne te gjitha tipet e germimeve ne brezin e lumit sipas situacionit dhe profilit te shtratit te lumit per thellimin dhe formsimin e shtratit te lumit.	m ³	43,750.00	0.26	11,375.00
2.2	Punimet e germimit te kategorise III dhe IV per kycjen e prrockave anesore ne shtratin e lumit.Keto kycje duhet te jene mire te punuara ne mynyre qe zbrazja e prrockave te jete sa me e lehte.	m ³	2,350.00	0.15	352.50
2.3	Punimet e mbushjes dhe ngjeshjes me dheun e germuar dhe furnizimi i dheut shtese ne pozicionete nevojshme qe nevojitet per te formsuar shtratin e lumit sipas krkese se terrenit.Gjithashtu ne kete sasi jane te perfshira edhe punimet e mbushjes per rrafshim,pergaditjes te zones perreth lumit ne forme argjinature si ne profil dhe te percaktuar sipas situacionit real ne terren.	m ³	11,250.00	0.20	2,250.00
2.4	Punimet e mbushjes dhe ngjeshjes me dheune e germuar dhe furnizimi i dheut shtese per ndertimin e brigjeve per kycjen e prrockave anesore.Ne cmim te parashifen edhe te gjitha kostot e transportit nga vendmarrja e dheut deri ne punishte.	m ³	1,600.00	0.10	160.00
2.5	Ne te tri urat ku kalon lumi te behet furnizimi mbushja dhe ngjeshja me material Zhavorr STERIL ne gjeresi se paku nga dy metra ne hyrje dhe dalje te seciles ure.	m ³	145.00	1.50	217.50
					14,355.00



**PASTRIMI DHE REHABILITIMI I LUMIT "KUJAVCA"
PERMBLEDHJE**

3.PUNËT E BETONIT DHE ARMIMIT					
Poz.3	Përshkrimi i pozicionit	Njësia	Sasia	Çmimi	Shuma
3.1	Furnizimi me material si dhe betonimi i themeleve të mureve me beton kualitativ C-25/30 per formsimin e kthesave qe te pamundesoje daljen e lumit nga shtrati.Pozicionet e kthesave jane te piketuara ne trasen e lumit dhe te njejta duhet te punohen me mure te betonit.	m ³	12.00	40.00	480.00
3.2	Furnizimi me material latimi dhe betonimi me beton kualitativ C-25/30,te mureve per formsimin e kthesave qe te pamundesoje daljen e lumit nga shtrati.Pozicionet e kthesave jane te piketuara ne trasen e lumit dhe te njejta duhet te punohen me mure te betonit.	m ³	45.00	40.00	1,800.00
3.3	Furnizimi me material si dhe montimi i konstruksionit te çelikut	kg	570.00	0.45	256.50
					2,536.50

Pos.	Përshkrimi i pozicionit	Shuma
1	PUNET NDERTIMORE	4,665.00
2	PUNET E DHEUT – GERMIMIT DHE MBUSHJES	14,355.00
3	PUNET E BETONIT DHE ARMIMIT	2,536.50
	Total PA TVSH	21,556.50
	TVSH	3,880.17
	TOTALI ME TVSH	25,436.67

